



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III-

Nr. I prot
Br. prot.

39

Më

Dt. 06.01.2025

RAHOVEC - ORAHOVAC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam
Department of Economy, Development and Tourism

Raporti i punës

Janar–Dhjetor, 2024



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm Odeljenje za Privredu, Razvoj i Turizam Department of Economy, Development and Tourism

DATË /A:	05.1.2025
PËR/ZA/TO :	z.Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
NGA/OD/FROM:	z.Erhan Morina, Drejtor për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm
LËNDA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti vjetor punës së DEZHT, për vitin 2024



Gjatë vitit 2024, Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm ka zhvilluar aktivitete të ndryshme:

-Në fillim-vit, prioritet i DEZHT, ka qenë inkasimi i borxheve të mbetura nga viti paraprak në sektorin për qira si dhe në taksa afariste;

-Në kuadër të aktiviteteve të DEZHT, gjatë vitit 2024 janë bërë vizita të ndryshme bizneseve të cilat operojnë në komunën tonë;

-Në vazhdimwsi janë monitoruar punimet në projektet kapitale si: Ndërtimi i Parkut Industrial në Opterushë, Ndërtimi i sheshit në qendër të qytetit të Rahovecit, Ndërtimi i lokaleve afariste zejtare, Investimet në shtigje dhe bujtina, Ndërtimi i shtandeve mobile. Kemi komunikuar vazhdueshëm me ministritë e linjës për të gjitha projektet që kemi në bashkëfinancim, jemi kujdesur për mirëmbajtjen e shtigjeve të ecjes.

-Poashtu në kuadër të aktiviteteve të DEZHT, në muajin e mërgimtarëve, DEZHT, ka organizuar takim me bizneset kosovare të cilat operojnë në diasporë si dhe bizneset lokale të komunës sonë, në këtë takim janë diskutuar ide dhe mundësi të bashkëpunimit mes këtyre biznesve.

Gjatë kësaj periudhe, DEZHT ka përgatitur disa pika drejtuar Kuvendit Komunal në Rahovec:

- Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale për vitin 2023;
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim përmes ankandit publik të parcelës te depot e matreksit në Xërxë;
- Vendimi për dhënien në shfrytëzim përmes ankandit publik të shtëpisë së verërave;
- Dhënia në shfrytëzim të dy lokaleve te palestra "Mizahir Isma".

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Poashtu në nëntor të vitit 2024, DEZHT, në bashkëpunim me Shoqatën Hareja, kanë mundësuar funksionalizimin e plotë të shtëpisë për të moshuar. Komuna e Rahovecit, ka mundësuar transportin, shujtën si dhe shtëpinë për të moshuar, ndërsa shoqata Hareja, ka menaxhuar me mbarvajtjen e dhe menaxhimin e shtëpisë për të moshuar.

Foto 1 dhe 2



KOMUNA RAHOVEC


Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm



Investimet Kapitale:

-Në projektin e Parkut Industrial në Opterushë, gjatë vitit 2024 kanë vazhduar punimet në realizimin e fazës së parë ndërkohë që me datë 15.03.2024, është nënshkruar marrëveshje e re bashkëpunimi me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për financimin fazës së dytë të Parkut Industrial. Vlera e bashkëfinancimit për këtë fazë është: 1,013,360.36€;

Foto 1 dhe 2



KOMUNA RAHOVEC

Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm



-Në korrik 2024, kanë përfunduar punimet në Projektin “Ndërtimi i Sheshit në Qendër të Qytetit”. Përmes këtij projekti është trajtuar qendra e qytetit në Rahovec.

Foto 1 dhe 2



KOMUNA RAHOVEC

Drejtorja për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm



-Në muajin gusht, ka përfunduar ndërtimi i 10 shtandeve mobile, projekt ky i cili është projekt në bashkëfinancim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Vlera e këtij projekti është :33,950.00€;

Foto 1



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

-Me datë 21 gusht 2024, është bërë përrurimi i projektit: “Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec”; Përmes realizimit të projektit “ Ndërtimi i Lokaleve Afariste Zejtare në Rahovec” është mundësuar krijimi i mundësive për 8 biznese potenciale të cilat kanë nevojë për një hapësirë (objekt) të re, të kompletuar me infrastrukturë të nevojshme.

Foto 1 dhe 2



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

- Në muajin nëntor në kuadër të DEZHT, janë subvencionuar 12 biznese Start Up, 4 nga këto biznese menaxhohen nga gratë .

Foto 1 dhe 2



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Sektori për Ekonomi:

-Në tre muajorin e parë të vitit 2024, janë përgatitur dhe janë dërguar aktvendime për 738 biznese të cilat sipas kodeve ekonomike ngarkohen me taksë afariste komunale. Ndërsa në periudhat TM2, TM3 dhe TM4, janë dërguar vërejtje me shkrim për të gjitha biznset të cilat kanë pasur vonesa në pagesat e taksave afariste.

Të hyrat dhe ngarkesa në taksë afariste ;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat në taksë komunale për vitin 2024	91,813.90€

Sektori për Zhvillim;

-Evidenca e të hyrave dhe ngarkesës së qirasë të lokaleve afariste dhe pronës së paluajtshme të Komunës së Rahovecit, sipas bazës së shfrytëzimit si pasuri e paluajtshme komunale me të cilat disponon komuna e Rahovecit, mbahet në mënyrë të rregullt.

Gjatë vitit 2024, në sektorin për zhvillim ekonomik, janë lëshuar gjithsej 66 pëlqime të punës. Poashtu, për të gjitha bizneset të cilat kanë pasur vonesa në pagesat e qerasë, janë dërguar vërejtje konform dispozitave ligjore që përcakton rregullorja për taksa komunale 01 NR: 80/20.

Të hyrat nga qiratë;

Nr.	Përshkrimi	Vlera në €
1	Të hyrat nga qiratë për vitin 2024	120,398.04€

Zyra e QKRB-së:

-Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës. Evidenca e regjistrimit të bizneseve të komunës së Rahovecit, sipas bazës së programit online të ARBK-së, mbahet në mënyrë të rregullt.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm

Tabela e kërkesave dhe e regjistrimit të bizneseve për periudhën janar-shtator 2024:

Nr.	Përshkrimi	Nr.
1	Biznese te reja B.i	74
2	Biznese te reja Sh.p.k	109
3	Biznese te reja Dega ne kosove	01
4	Informata te biznesit	211
5	Vertetim individual	21
6	Shuarje te biz.	24
7	Nui	41
8	Certifikat duplikat	11
9	Historik te biznesit	01
10	Ndryshyme ne biznese	110
11	Vertetim i biznesit	23
12	Pune tjera me pale	25
13	Lende te anuluar	01
TOTALI		652

Menaxhimi i Asteteve komunale

- Të gjitha transaksionet që kanë ndodhur gjatë vitit 2024, janë regjistruar me kohë në sistemin e-pasuria dhe SMFK.
- Është bërë inventarizimi i aseteve komunale për vitin 2024;
- Në dhjetor është shpallur ankandi publik, për shitjen e aseteve të pa përdorëshme të komunës;

Sektori i Turizmit

- Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, në vazhdimësi është kujdesur për promovimin e potencialeve turistike të Komunës së Rahovecit;
- Kanë vazhduar Investimet në zgjerimin e shtigjeve të ecjes në Zatriq dhe Zoqisht;

KOMUNA RAHOVEC

Foto 1, 2 dhe 3




-Janë shenjëzuar mbi 20 km shtigje për Hiking në tërë teritorin e Komunës së Rahovecit;



KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm



Në raportin e përformanës për vitin 2024 DEZH në të dy indikatorët ka treguar përformancë të lartë.

- Treguesi: 16.1.1 - Strategjia për zhvillim ekonomik lokal me pikë 100%
- Treguesi: 16.1.2 - Përgatitja dhe publikimi i listës së pronave komunale të planifikuar për dhënie në shfrytëzim me pikë 100%

Me respekt!

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm